



## NJOFTIM

### Tarifat e ngrohjes për NQ Termokos dhe NQ Gjakova të njëjta me ato të vitit të kaluar

Bordi i Zyres së Rregullatorit për Energji (ZRRE), në mbledhjen e mbajtur dje me 11 nëntor 2014, ka vendosur që tarifat e ngrohjes qendrore për shërbimet e ndërmarrjes NQ Termokos në Prishtinë dhe ato të ndërmarrjes NQ Gjakova, në Gjakovë, për sezonin 2014/2015, të mbesin të njëjta si në sezonin e kaluar 2013/2014.

Në lidhje me tarifat e NQ Termokos, ZRRE ka vlerësuar se arsyeja kryesore qëndron në realizimin e vonuar dhe të pjesshëm të realizimit të projektit të kogjenerimit. Sipas dinamikës së kryerjes së punimeve pritet që kyçja në njësinë B1 të përfundoj me 18 nëntor , ndërsa rreth datës 24 nëntor pritet të startoj furnizimi me ngrohje nga ky projekt. Duhet theksuar se kyçja e pajisjeve për marrjen e avullit në njësinë B2 nuk është realizuar dhe se realizimi i saj është shtyrë për vitin e ardhshëm. Rrjedhimisht fillimi i prituri i furnizimit me ngrohje nga kogjenerimi është shtyrë mbi një muaj pas fillimit zyrtarë të sezonit të ngrohjes. Gjithashtu ndryshimet në operim, ndryshimet në kostot e përgjithshme si dhe ato në furnizim me ngrohje pritet të jenë të konsiderueshme si rrjedhojë e projektit të kogjenerimit. Për këtë si dhe duke mos qenë të sigurt në realizimin e tërësishëm të projektit është konsideruar se është e vështirë të bëhen planifikime reale për tu përfshirë në aplikacion tarifor.

Po ashtu është vlerësuar se nevojitet se paku një sezonë e ngrohjes për të marrë të dhëna dhe informata të mjaftueshme për kostot operative dhe kostot kapitale, dhe për sasi të prodhuara të energjisë termike nga kogjenerimi.

Ndërsa sa i përket tarifave për NQ Gjakova, arsyet kanë qenë kryesisht të ndërlidhura me vështirësitë e mëdha financiare me të cilat aktualisht ballafaqohet NQ Gjakova, që vënë në pikëpyetje aftësinë e ndërmarrjes për të siguruar lëndën djegëse – mazutin. Mes tjerash në këtë situatë të vështirë kanë ndikuar borxhet ndaj furnitorëve dhe kontraktorëve të ndryshëm, të shkaktuara në të kaluarën, e që sipas aktgjykimeve të formës së prerë është dashur që të paguhen në këtë vit. Kjo ka ndikuar që e gjithë shuma e mbetur e subvencioneve të këtij viti të shpenzohet për pagesat e borxheve paraprahe.

Po ashtu arsye tjetër është pasigurinë rreth subvencioneve nga buxheti i Kosovës, ku për shkak të mos rishikimit të buxhetit, nuk është e sigurtë nëse do të ketë dhe sa do të jetë shuma e subvencionit për vitin kalendarik 2014 dhe në total për sezonin 2014/2015. Kjo është mjaft e rëndësishme kur dihet se një pjesë e konsiderueshme e shpenzimeve për lëndë djegëse mbulohen nga subvencionet.

ZRRE ka konsideruar se mungesa e subvencionit dhe aftësia shumë e limituar financiare për të siguruar lëndën djegëse e vënë në pikëpyetje se në që masë NQ Gjakova mund të ofroj furnizim me ngrohje në sezonin 2014/2015.

Këto kushte e kanë bërë shumë të vështirë planifikimet e duhura për një aplikim tariforë të kompletuar dhe të bazuar në parashikime reale, prandaj ZRRE ka vendosur që të vazhdohet me aplikimin e tarifave të njëjta si të sezonës së kaluar.



Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur tarifat e ngrohjes për NQ Termokos dhe NQ Gjakova për sezonin 2014/2015.

**Tabela 1: Tarifat e ngrohjes të NQ Termokos për sezonin 2014/2015**

TARIFAT PËR NGROHTOREN E QYTETIT TERMOKOS SH.A PËR SEZONIN E NGROHJES 2014/2015		
Tabela A . TARIFA PËR KONSUMATORËT PA MATJE		
NGROHTORJA E QYTETIT TERMOKOS SH.A		
Komponentet e Tarifave	Konsumatorët shtëpiakë	Konsumatorët Komercialë e Institucionalë
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	0.07 [€/m <sup>2</sup> për muaj ]	0.08 [€/m <sup>2</sup> për muaj ]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	0.77 [€/m <sup>2</sup> për muaj ]	0.92 [€/m <sup>2</sup> për muaj ]
Tabela B .TARIFA PËR KONSUMATORËT ME MATJE		
NGROHTORJA E QYTETIT TERMOKOS SH.A		
Tarifa mujore e kapacitetit të ngrohjes (komponenta fikse)	0.66 [€/kW për muaj]	
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	45.50 [€/MWh ]	

**Tabela 2: Tarifat e ngrohjes të NQ Gjakova për sezonin 2014/2015**

TARIFAT PËR NGROHTOREN E QYTETIT GJAKOVË SH.A PËR SEZONIN E NGROHJES 2014/2015		
Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT PA MATJE		
NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVË SH.A		
Komponentet e Tarifave	Konsumatorët shtëpiakë	Konsumatorët Komercialë e Institucionalë
Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes (komponenta fikse)	0.09 [€/m <sup>2</sup> për muaj]	0.12 [€/m <sup>2</sup> për muaj]
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	0.88 [€/m <sup>2</sup> për muaj]	1.27 [€/m <sup>2</sup> për muaj]
Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT ME MATJE		
NGROHTORJA E QYTETIT GJAKOVË SH.A		
Tarifa mujore e kapacitetit të ngrohjes (komponenta fikse)	0.91 [€/kW për muaj]	
Tarifa për ngrohjen e furnizuar (komponenta variabile)	58.76 [€/MWh]	

Sqarim:

Lidhur me deklaratat në media për tarifat e ngrohjes të NQ Termokos dëshironim të sqarojmë se, tarifa e ngrohjes **vetëm për konsumatorët komercial e Institucional është 1 €/m<sup>2</sup>, ndërsa tarifa për konsumatorët shtëpiak është 0.84 €/ m<sup>2</sup>**, ashtu siç paraqitet në tabelën më lartë. Është me rëndësi të përmendet tarifat e përcaktuara nga ZRRE nuk përbajnë vlerën e TVSH-së.